



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

TITULLI I INFORMACIONIT dhe PËRMBAJTJA:

Informacion për zbatimin e Strategjisë për zhvillimin e ndërmarrësisë së grave në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2019 -2023

Ky informacion është përgatitur me qëllim që të informohet Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për aktivitetet e ndërmarrja për zbatimin e Strategjisë për zhvillimin e ndërmarrësisë së grave në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2019 - 2023, e cila është miratuar më 04.12.2018.

Bazë për përgatitjen e këtij informacioni është Konkluzioni nga seanca e njëqind e gjashtë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mbajtur më 04.12.2018, me të cilin:

3. Ministria e Ekonomisë është e obliguar që një herë në vit ta informojë Qeverinë për rrjedhën e zbatimit të Strategjisë për zhvillimin e ndërmarrësisë së grave në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2019 - 2023.

Informacioni është përgatitur përmes procesit të konsultimit me anëtarët e Grupit të Punës për zbatimin e Strategjisë për zhvillimin ndërmarrësisë së grave. Në Informacion janë përfshirë përgjigjet për aktivitetet e realizuara në përputhje me masat e parashikuara në Planin Aksional të Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik, Agjencisë për Ndërmarrësi dhe Konkurrencë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Entit Shtetëror për Statistikë, Regjistrin Qendror, Lidhjes së e Odave Ekonomike dhe Shoqatës së Grave Afariste.

Pjesë përbërëse e këtij informacioni është Plani Aksional për zbatimin e Strategjisë për zhvillimin e ndërmarrësisë së grave në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2019 - 2023, i plotësuar me aktivitetet e realizuara sipas masave të caktuara të planit aksional, deri më 31.11.2021.

Pandemia Covid ka ndikuar që disa nga masat dhe aktivitetet e parashikuara të Strategjisë, të mos zbatohen në kornizën e paraparë kohore, por megjithatë, gjatë periudhës së kaluar, përmes masave të qeverisë kundër krizës, janë parashikuar dhe zbatuar masa për mbështetjen e ndërmarrësisë së grave kurse institucionet përgjegjëse, pavarësisht reduktimit të buxheteve vjetore dhe burimeve të kufizuara njerëzore, arritën të realizojnë një sërë aktivitetesh që synojnë realizimin e prioriteteve strategjike të përcaktuara në strategji.

Në mënyrë të përmbledhur, janë realizuar aktivitetet e mëposhtme në drejtim të arritjes së prioriteteve të caktuara strategjike

Prioritet strategjik 1: Krijimi i ambientit të volitshëm afarits (klime biznesore) për zhvillimin e ndërmarrësisë së grave

Në drejtim të realizimit të këtij prioriteti strategjik, janë realizuar dhe nisur aktivitetet e mëposhtme me qëllim koordinimin gjatë krijimit dhe zbatimit të politikave për zhvillimin e sipërmarrjes së grave, analizën e rregullativës që ndikon në aktivitetin e sipërmarrjes së grave dhe krijimin e statistikës për monitorimin e aktivitetit sipërmarrës (afarist) të grave:

Është krijuar grup ndërministror i punës, i përbërë nga përfaqësues nga ministrinë dhe organet kompetente, të përmendura në Planin Aksional, si dhe përfaqësues nga odat ekonomike, odat e zejtarëve dhe shoqatave që punojnë në zhvillimin e ndërmarrësisë së grave. Anëtarët e grupit të punës janë në komunikim të vazhdueshëm elektronik për monitorim më të mirë të të gjitha aktiviteteve të ndërmarrja në drejtim të realizimit të planit aksional.

Ministria e Ekonomisë çdo vit në muajin dhjetor rregullisht i dorëzon Qeverisë Informacionin për zbatimin e Strategjisë për zhvillimin e ndërmarrësisë së grave në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2019 - 2023.

Me qëllim të përfshirjes aktive të të gjitha palëve të prekura në zbatimin e aktiviteteve të parapara në planin aksional të Strategjisë për zhvillimin e ndërmarrësisë së grave dhe ngritjen e nivelit të bashkëpunimit, Ministria e Ekonomisë në tetor 2021 nënshkroi Memorandum për bashkëpunim me



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Platformën nacionale për sipërmarrësi të grave, e themeluar nga Shoqata e Grave Afariste, Lidhja e Odave Ekonomike të Maqedonisë, Federata Nacionale e Fermerëve dhe Fondacioni për Menaxhment dhe Hulument Industrial.

Ministria e Ekonomisë në fund të vitit 2019, ka bërë “Analizë të taksave parafiskale për NVM-të”. Me këtë analizë u identifikuan taksat parafiskale në nivel qendror dhe lokal nga aspektet e organeve kompetente për PFD-të e ndryshme dhe strukturën e tyre, ekspozimin e kompanive sipas sektorit dhe madhësisë, koston dhe mënyrën e llogaritjes së taksave parafiskale, aspekte të ndryshme të barrës së taksave parafiskale dhe barra e kompanive me taksat parafiskale ndaj pushtetit qendror dhe lokal. Kjo analizë njëherisht është edhe bazë për përcaktimin e mëtejshëm të rregullativës që prek aktivitetin sipërmarrës të grave.

Ministria e Ekonomisë në bashkëpunim me Delegacionin e Komisionit Evropian në fillim të vitit 2021 përgatiti propozim-projekt “Udhëzime për përdorimin e taksave parafiskale” i cili është dorëzuar në DBE-së, për përfitimin e mbështetjes profesionale përmes IPA fondeve. Me këtë projekt parashikohet realizimi i rritjes së transparencës dhe parashikueshmërisë së taksave që kanë karakter të taksave parafiskale; heqjes, optimizimit dhe racionalizimit të të paktën 100 taksave parafiskale për punë biznesore; forcimi i kapaciteteve të institucioneve publike (ministrive) të ngarkuara me krijimin e politikave dhe zbatimin e rregullave dhe politikave që synojnë heqjen dhe parandalimin e taksave të pajustificuara parafiskale. Projekti është pranuar nga DBE dhe është në fazën e përzgjedhjes së konsulentit për zbatimin e të njëjtit.

Enti Shtetëror për Statistikë në mars të vitit 2021 publikoi edicionin e dymbëdhjetë të publikimit "Gratë dhe burrat në Maqedoninë e Veriut", të përgatitur në bazë të të dhënave të mbledhura nga Enti Shtetëror për Statistikë, përmes statistikave gjinore gjithnjë e më të zhvilluara. Në këtë edicion vazhdoi kontinuiteti i të dhënave të publikuara, por u prezantuan edhe përmbajtje të reja që japin pasqyrë të karakteristikave demografike të grave dhe burrave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe përfaqësimin e tyre në jetën sociale dhe ekonomike në vend.

Një numër i madh i institucioneve kanë vendosur kriter gjinor në burimet e informacionit dhe në regjistrat zyrtarë që drejtojnë. Çdo institucion integron gjithnjë e më shumë komponentin gjinor në planet strategjike, politikave dhe buxhetet dhe respekton parimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat. Në procesin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor janë përfshirë 13 ministri dhe dy agjensione shtetërore të cilat janë të detyruar të zbatojnë analizë gjinore bazë për programë sektoriale të përcaktuar dhe të zhvillojnë tregues të rezultateve gjinore, si dhe të vazhdojnë të përcjellin progresin në zbatimin e programeve të përzgjedhura dhe ndikimin e tyre. Insitucionet përgatisin Raport vjetor për aktivitetet e ndërmarra dhe pogradin e arritur për krijimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat.

Prioriteti strategjik 2: Sigurimi i mbështetjes sistemore për zhvillimin e sipërmarrësisë së grave

Arritja e këtij prioriteti strategjik parashikon realizimin e aktiviteteve për përmirësimin e qasjes deri në forma të volitshme të financimit, tranzicionin nga ndihma sociale në vetëpunësim, tranzicionin nga i punësuar në punëdhënës, sigurimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme dhe forcimin e pranisë së grave në krijimin e politikave për zhvillimin e sipërmarrësisë.

Në periudhën e kaluar janë realizuar dhe nisur këto aktivitete:

Me qëllim të nxitjes së aktivitetit ekonomik të grave, Qeveria i ngarkoi institucionet kompetente shtetërore që gjatë krijimit të programeve/masave/thirrjeve publike të tyre, të parashikojnë kriteret stimuluuese për vlerësimin e aplikacioneve/projekteve nëse të njëjtat, janë dorëzuar nga anëtarët e gjinisë femërore, apo të vendosin masa të reja për mbështetje, ekskluzivisht për gratë (Draft-procesverbal nga seanca e 169-të e Qeverisë, e mbajtur më 10.12.2019, pika 34).

Ministria e Ekonomisë, krahas masës së veçantë të projektuar për mbështetje financiare të ndërmarrejeve në pronësi dhe udhëheqje të grave, të cilën e zbaton nga viti 2012, në Programin vjetor për Konkurrueshmëri, Inovacion dhe Sipërmarrje, për vitin 2020 dhe 2021 ka vendosur kriteret



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

stimuluese nëse aplikuesi është subjekt biznesi në pronësi dhe e udhëhequr nga gratë, dhe kjo zbatohet.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave nga viti 2019 ka nisur realizimin e masës së dizajnuar në mënyrë specilae për anëtare grua aktive në ekonominë e bujqësisë. Kjo masë është realizuar në vitin 2020 dhe 2021 dhe si rezultat i masës numri i grave të regjistruara në ERZS si bartëse të ekonomive bujqësore është vazhdimisht në rritje, gjë që është veçanërisht e dukshme në tre vitet e fundit.

Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik në thirrjen publike - Grante të kofinancuara për zhvillim teknologjik për tejkalimin e pasojave nga KOVID-19, ka vendosur masë stimuluese ku aplikuesit që kanë për drejtues ose pronar grua, gjatë notimit profesional marrin 5 pika shtesë. Në vitin 2020, në kuadër të instrumentit "Grantet e kofinancuara për zhvillim teknologjik për tejkalimin e pasojave nga KOVID-19", si nënkriter për vlerësim u vendos zhvillimi i barabartë rajonal dhe përfaqësimi i barabartë gjinor.

Masë stimuluese me mundësi të pikëve shtesë gjatë vlerësimit të aplikuesve që kanë për drejtues apo pronar grua, është vendosur edhe me shpalljen publike sipas instrumentit Grante të kofinancuara për zhvillim teknologjik për rritje të përshpejtuar ekonomike, i cili u publikua në fillim të vitit 2021. Si rezultat i këtyre masave stimuluese, pjesëmarrja e grave sipërmarrëse në totalin e portofolit të Fondit, është rritur nga 33 në 41%.

Në kuadër të pakos së tretë të masave kundër krizës për përballjen me pandeminë KOVID, Banka për Zhvillim e Maqedonisë së Veriut realizoi masën - kredi pa kamatë me grant 30% si mbështetje për gratë, të rinjtë dhe firmat që vendosin dixhitalizim në biznes ose janë të orientuar kah eksporti, pas çka prej 2703 subjekte të mbështetura me masën, 1062 subjekte janë të themeluara nga gra ose të drejtuara prej grave.

Në kuadër të Bankës Zhvillimore të Maqedonisë së Veriut është themeluar Fondi Garantues si njësi e veçantë organizative - Njësia e Fondit Garantues në kuadër të Sektorit për Kreditim dhe Garancione. Fondi garantues është shtylla e skemës së kredit-garantuese, përmes së cilës mbështetet sektori privat, përmes sigurimit të një pjese të kolateralit për kreditë e miratuara nga bankat dhe kursimoret.

Ministria e Ekonomisë në kuadër të Programit për Konkurrueshmëri, Inovacion dhe Sipërmarrje për vitin 2019 realizoi masën "Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për pjesëmarrje në panaire vendase, rajonale dhe ndërkombëtare. Me këtë masë mbështetet financiarisht NMVM-të për pjesëmarrje në panaire vendase, rajonale dhe ndërkombëtare përmes kofinancimit të 60% të shpenzimevetë vërtetuara për marrjen me qira të një stende.

Ministria e Ekonomisë dhe Projekti i USAID-it për Zhvillimin e Ekosistemit të Biznesit organizuan takim informues në vitin 2020 dhe 2021, me qëllim prezantimin e masave për mbështetjen e NMVM-ve në Programin e Konkurrueshmërisë, Inovacionit dhe Sipërmarrjes.

FITR zbaton qasje multimediale për informimin e publikut. Në vitin 2020, veçanërisht për shkak të pandemisë Covid-19, më shumë theksi u vu në komunikimin dixhital dhe prezantimin online të të gjithë informacionit që lidhet me punën e Fondit.

Me qëllim të përmirësimit të edukimit financiar si të kompanive ashtu edhe të popullsisë, është përgatitur dhe miratuar "Strategjia për edukim financiar dhe përfshirje financiare 2021-2025". Gjithashtu, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministria e Financave në vazhdimësi zbatojnë fushata edukative për të prekur të gjitha segmentet e shoqërisë.

Ende nuk është krijuar platforma kombëtare online e mbështetur në mënyrë institucionale për ueb seminare dhe shërbime këshilldhënëse, por funksionon ueb platforma edukative <https://pretpriemacedu.mk/>, e cila synon të kontribuojë në rritjen e konkurrencës dhe inovacionit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke siguruar mundësi për edukimin e tyre online, mbi temat përkatëse në fushat e sipërmarrjes, inovacionit, politikës industriale dhe ekonomisë qarkulluese. Krijimi i platformës mbështetet nga projekti "Forcimi i kapaciteteve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

mbështetjes së përmirësuar për inovacione", të financuar nga Bashkimi Europian, në kuadër të programit IPA për forcimin e konkurrencës së ekonomisë nacionale, i implementuar nga Fondacioni për Shërbim Sipërmarrës për të Rinjtë.

AMSRMV merr pjesë në realizimin e projektit rajonal "Vendosje dhe promovimi i shërbimeve të mentorimit për NVM-të në Ballkanin Perëndimor – Faza 2", mbështetur nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar – JICA. Qëllimi kryesor i projektit është dizajnimi i një "Sistemi" të qëndrueshëm të shërbimeve të standardizuara të mentorimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë rrjetin ekzistues të Qendrave Rajonale (QR), si instancë fillestare nga e cila rekrutohen mentorët e ardhshëm. Gjatë vitit 2019 dhe 2020 janë rekrutuar gjithsej 20 mentorë, nga të cilët 11 janë gra dhe janë mentoruar 69 NVM.

Fondi për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik, përveç mbështetjes financiare, mundëson edhe trajnime mentoruese për përdoruesit e tij. Për përdoruesit aktivë të FITR-it, sigurohet mentorim nga ekspertë vendas sipas nevojave individuale specifike të secilit përdorues dhe për këtë arsye u ofrohet mentorim individual. Në vitin 2021, në trajnimet e mentorimit janë përfshirë 168 përdorues të mbështetjes financiare të FITR-it, 78 prej të cilëve pronare ose drejtuese kanë një grua.

Në muajin maj të vitit 2021 është vendosur Platforma Nacionale për Sipërmarrje të Grave, e themeluar nga Shoqata e Grave Afariste, Shoqata e Odave Ekonomike të Maqedonisë, Federata Nacionale e Fermerëve dhe Fondacioni për Menaxhment dhe Hulumtime Industriale MIR. Qëllimi i platformës është të forcojë kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile për krijimin e propozim - politikave - publike dhe përfaqësim në fushën e sipërmarrjes së grave, duke bashkuar rrjetet ekzistuese në një platformë të vetme që do të paraqet interes për gratë sipërmarrëse në të gjitha nivelet. PNSG është anëtare e Shoqatës Botërore të Grave Afariste (FCEM), Koalicionit Ballkanik të Grave Afariste (B-WCo), Platformës për Sipërmarrjen e Grave (WEP) dhe shumë organizatave të tjera ndërkombëtare në të cilat organizatat partnere janë anëtare dhe kështu ofrohet mundësi për lidhje të bizneseve në nivel lokal, nacional, rajonal dhe më gjerë.

Prioriteti strategjik 3: Krijimi i infrastrukturës për mbështetje dhe zhvillim të sipërmarrësisë së grave

Për arritjen e këtij prioriteti strategjik, janë zbatuar dhe nisur aktivitetet e mëposhtme me qëllim zhvillimin e programeve të reja/moderne për arsim dhe trajnimin për sipërmarrje me fokus të veçantë tek gratë sipërmarrëse, forcimi i kapaciteteve për dhënien e shërbimeve për trajnim dhe këshillim të grave, sigurimin e kapacitetit për shfytëzimin e inkubatorëve, akceleratorëve dhe parqeve teknologjike nga ana e grave sipërmarrëse, bashkëpunimi me pushtetin lokal për përfshirjen e zhvillimit të sipërmarrjes së grave në programet lokale dhe rajonale për zhvillim, bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe vendosja e bazave të të dhënave/regjistrit të grave sipërmarrëse:

AMSRMV në programet e saj vjetore ka paraparë aktivitet të veçantë programor - Trajnime për mbështetjen e sipërmarrësisë së grave që realizohen në qytete të ndryshme. Përveç këtyre trajnimeve, AMSRMV në kuadër të aktiviteteve të saj programore, çdo vit organizon trajnime të ndryshme me tema të ndryshme të dedikuara për grupe të ndryshme të synuara.

Në vitin 2020, në kuadër të Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik, filloi ndarja e vauçerit për inovacion me qëllim tejkalimin e dobësive në transferimin e njohurive ndërmjet sektorit publik dhe privat si dhe në bashkëpunimin ndërmjet komunitetit akademik dhe industrisë. Vauçerët e inovacionit paraqesin nxitje financiare të cilën ndërmarrjet e shfrytëzojnë për mbulimin e një pjesë të shpenzimeve nga shërbimet që i ofrojnë institucionet akademike dhe shkencore - hulumtuese.

Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik dhe PricewaterhouseCoopers (PwC) Maqedonia e Veriut kanë zhvilluar program mentorimi pa pagesë The Catalyst i cili synon të forcojë kapacitetin e startup-eve në tema dhe fusha që janë të rëndësishme për punën e përditshme, përvetësimin e njohurive dhe aftësive të



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

reja, si dhe lehtësimin e qasjes para investitorëve potencialë. Ky program mentorimi do të realizohet në fund të vitit 2021.

AMSRMV ka zhvilluar një infrastrukturë partneriteti me qendrat rajonale të biznesit dhe universitetet për dhënien e shërbimeve të trajnimit. Ky bashkëpunim realizohet në nivel vjetor pas procedurave të zbatuara për prokurime publike të shërbimeve arsimore dhe shërbimeve të përmirësimit profesional në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik.

FITR, me mbështetjen e Bankës Botërore, ka ndarë mbështetje financiare në vlerë prej 2 milionë eurosh përmes Thirrjes publike për financimin e akceleratorëve teknologjikë me qëllim të përshejtimit të zhvillimit të ideve inovative, validimit të tregut por edhe ndërtimit të modeleve të biznesit të shkallëzuar dhe të qëndrueshëm për startup-et e Maqedonisë, për tre akceleratorë edhe atë: Akcelerator afarist-teknologjik UKIM SHPK Shkup, Seavus AKcelerator në Shkup dhe X Factor në Veles.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në kuadër të njërive të vetëqeverisjes lokale në periudhën nga nëntori 2017 deri në tetor 2021, janë themeluar 80 Komisione për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, përveç në Tearcë. Pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale në tetor të vitit 2021, është në rrjedhë procesi i krijimit të Komisioneve të reja për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat për periudhën 2021-2025.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka paraparë dhe në kuadër të orës klasore, realizon programe për aftësi jetësore që përfshijnë tema për barazinë gjinore për çka janë përpiluar, programe dhe manuale nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit. Gjithashtu, në programin mësimor të edukimit qytetar përfshihen tema dhe përmbajtje për barazinë gjinore, pranimin dhe respektimin e diversitetit. Në kuadër të aktiviteteve jashtëshkollore, realizohet projekti "Mbështetje për Arsimin e Sipërmarrjes në Evropën Lindore dhe Euroazi" me qëllim njohjen më të madhe të arsimit mbi sipërmarrjen në vend, si dhe me qëllim ndërtimin e partneriteteve ndërmjet sektorit të arsimit dhe sektorit të biznesit, për përmirësimin e relevancës së arsimit, rritjen e ndikimit të arsimit, si dhe modernizimin e djemve dhe vajzave të shkollave të mesme dhe hyrjen e tyre në shëkullin e 21-të.

Institucionet e arsimit të lartë, si autonome, kanë lirinë për nënshkrimin e memorandumeve dhe marrëveshjeve për bashkëpunim me shoqata dhe kompani të ndryshme. Sipas Ligjit për Arsimin e Lartë, neni 86 paragrafi 1, Universiteti themelon së paku një qendër karriere, e cila ndër aktivitetet e tjera, ka për detyrë t'u japë studentëve udhëzime dhe këshilla në zgjedhjen e profesionit dhe karrierës, pa paragjykitime dhe qëndrime diskriminuese.

Prioriteti strategjik 4: Promovimi, rrjetëzimi dhe përfaqësimi

Për arritjen e këtij prioriteti strategjik, janë realizuar aktivitetet e mëposhtme për promovimin e sipërmarrjes së grave dhe rritjen e kapacitetit të shoqatave biznesore të të grave:

Në maj 2021, u vendos Platforma Nacionale për Sipërmarrjen e Grave (PNSG) si partner kryesor social për krijimin e politikave dhe proceseve reformuese; lehtësimin e dialogut strukturor, rrjetëzimin dhe konsultime ndërmjet palëve të prekura të SG-së në nivel nacional dhe lokal; përmirësimin e kapaciteteve të organizatave civile për SG për politikë, përfaqësimin dhe bashkëpunim me qeverisjen nacionale dhe lokale; promovimin e grave sipërmarrëse si shtytëse të ndryshimit në politikat publike.

Më 18 dhe 19 nëntor 2021, është mbajtur Samiti i parë vjetor i Platformës Nacionale për Sipërmarrjen e Grave me temë "Perspektiva të reja për sipërmarrjen e grave". Samiti kishte për qëllim të rrisë dukshmërinë e platformës dhe përfitimeve që ajo siguron për palët e prekura dhe për sipërmarrjen e grave, të ndahen praktikrat dhe idetë më të mira dhe të promovohen politika që mbështesin sipërmarrjen e grave.



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në korrik të vitit 2021, Qeveria miratoi Vendim për ndarjen e mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 166/21), me të cilin ndahen 19.800.000 denarë nga mjetet e planifikuara në buxhetin e shtetit për 33 organizat të shoqërisë civile për projekte në 7 fusha prioritare. Nga 33 projektet e mbështetura, tre kanë aktivitete konkrete që lidhen me sipërmarrjen e grave (Edukimi dhe Karriera - Sfida për Vajzat dhe Gratë e Reja (WomenInStem), Fuqizimi Ekonomik i Grave dhe të Rinjve nga Mjediset Rurale, crucial për zhvillim të qëndrueshëm, dhe e-tregu rural i grave).

Ministria e Ekonomisë si sponsor institucional dhe Platforma Nacionale për Sipërmarrjen e Grave për herë të parë, më 18 Nëntor 2021 organizoi "Përzgjedhja e Gruas – Sipërmarrëse e Vitit", në kuadër të Samitit dyditor për Gratë Sipërmarrëse. Përzgjedhja e grave më të suksesshme sipërmarrëse në kategorinë e sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme është bërë sipas kriterëve të paracaktuara dhe bazuar në të dhënat zyrtare nga llogaritë përfundimtare të ndërmarrjeve në pronësi dhe udhëheqje të grave, të cilat Ministria e Ekonomisë i siguroi nga Regjistri Qendror.

Në periudhën në vijim do të vazhdojë realizimi i aktiviteteve të mbetura të parapara në Planin Aksional të Strategjisë për Zhvillimin e Sipërmarrjes së Grave 2019-2023.